



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

Vendim

Nr. 31 Date 22.09.2017

" Për miratim të Lejes së Përdorimit të Ujit për prodhim të energjise elektrike, nëpërmjet ndërtimit të HEC "TRAJA 1", në rrjedhën së Përroit të Zallit të Trajës degë e Lumit Mat në Bashkinë Mat, Qarku Dibër nga Subjekti "A.R.M- ALBANIA" sh.p.k.

-Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 51 dhe nenit 52 te ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", vendimin nr.416 datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave " Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe Leje për përdorim të burimeve ujore", nenit 24 të Vendimit të KM nr. 822, date 07.10.2015,"Per miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni"(i ndryshuar) si dhe miratimit paraprak Nr. 908/5 Date 30.05.2017 të Ministrisë të Energjisë dhe Industrisë, me propozim te A.B.U. Mat

Këshilli i Basenit Ujor Mat,

Vendosi:

1-Miratimin e Lejes të Përdorimit të Ujit për prodhim të energjise elektrike, nëpërmjet ndërtimit të HEC "TRAJA 1", në rrjedhën së Përroit të Zallit të Trajës degë e Lumit Mat në Bashkinë Mat, Qarku Dibër nga Subjekti "A.R.M- ALBANIA" sh.p.k. me Administrator Z. Fatos Malaj, me këto të dhëna:

Hec- Trajan 1

Rrjedha e Përroit të Zallit të Trajes degë e Lumit Mat

-Prurja mesatare : Q= 0.71 m3/sek,

-Prurja llogarites: Q= 0.9m3/sek,

-Prurja ekologjike: Q= 0.022 m3/sek,

-Prurje per perdorime te tjera: _____ m3

-Kuota e aksit te vepres se marrjes: Z- 370m.n.d X – 44 08 280 Y- 46 09 380

-Kuota e godines se HEC-it : Z-230 m.n.d X – 44 09 940 Y- 46 11 960

- Fuqia e instaluar : 982kw

- Kapaciteti prodhues mesatar: 3 037 287Kwh

2- Nuk lejohet ndryshimi i regjimit të vaditjes,i furnizimit me ujë të popullatës etjerë nga përdorimi i ujit për energji elektrike.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËRGJEGJËSI I A.B.U. MAT

Ast NIKOULA



KRYETARI I K.B.U. MAT

Eduard NDRECA

